



**Agjencia e Punësimit
e Republikës së Maqedonisë**

Në bazë të Planit operativ për masa aktive për punësim dhe shërbimeve në tregun e punës për vitin 2017, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë, më datë **20.02.2017** bën

SHPALLJE PUBLIKE

për
personat e papunë

1. U bëhet thirrje personave të evidentuar si të papunë, të cilët në mënyrë aktive kërkojnë punë dhe të cilët duan që punësimin e tyre ta zgjidhin me mbështetjen financiare përmes **Programit për vetëpunësim**, që të paraqiten në klubet e punës së qendrave të punësimit të APRM-së, ku rregullisht evidentohen si të papunë. Personat të cilët kanë shfrytëzuar mbështetje financiare përmes Programit për vetëpunësim gjatë viteve të kaluara, nuk kanë të drejtë përsëri të aplikojnë.

Inkurajohen të rinjtë që janë kërkues aktiv të punës që punësimin e tyre ta zgjidhnin me anë të mbështetjes financiare përmes **Programit për vetëpunësim**.

Njëherit ftohen dhe gjithë kandidatët-kërkues aktiv pune, të cilët në kuadër të Programit për vetëpunësim 2016 kanë fituar statusin: (1) kandidat i përzgjedhur për themelimin e veprimtarisë mjekësore ose juridike, e që për arsye objektive nuk ka themeluar biznesin deri në fund të vitit 2016, ose (2) kandidat rezervë për themelim biznesi, ose (3) kandidat rezervë për përpilimin e planit të biznesit, të paraqiten në klubet e punës së qendrave të punësimit. Këta kandidatë, në varësi nga statusi i tyre dhe pikët e grumbulluara, do të kenë mundësi për kyçje të drejtpërdrejtë në fazën e ardhshme të Programit për vetëpunësim, ose të vlerësohen përsëri në kuadër të ciklit 1 për vitin 2017.

2. Programi për vetëpunësim nuk do të mbështesë themelimin e biznesit në:

- veprimtarinë bujqësore, përkatësisht nga sektori A/A, departamenti 01, prodhime bimore dhe shtazore, veprimtari gjuetie dhe shërbime që janë të lidhura me to, **me përjashtim të veprimtarive:**
 - o 01.41 – Kultivim i lopëve qumështore
 - o 01.41 – Kultivim i viçave, demave dhe buajve
 - o 01.45 – Kultivim i deleve dhe dhive
 - o 01.46 – Kultivim i derrave
- Prodhimi dhe distribuimi i armëve, gjegjësisht veprimtari nga klasa 25.40-Prodhim i armëve dhe municionit

- Biznese financiare dhe sigurimi dhe aktivitete që përfshijnë loja të fatit, gjegjësisht veprimtari nga Sektori K/I- Veprimtari financiare dhe sigurimi
- Tregti me shumicë dhe pakicë me automjete dhe motoçikleta, dhe servisim i automjeteve dhe motoçikletave, gjegjësisht veprimtari nga departamenti 45, **me përjashtim të veprimtarive:**
 - o 45.20 – Mirëmbajtje dhe servisim i automjeteve
 - o 45.32 – Tregti me pakicë me pjesë këmbimi dhe pajisje për automjete
 - o 45.40 –Tregti me motoçikleta dhe pjesë këmbimi dhe pajisje për motoçikleta, mirëmbajtje dhe servisim i motoçikletave
- Tregti me shumicë, gjegjësisht veprimtari nga departamenti 46
- Biznese nga fusha e transportit (taksi) ,
- Veprimtari nga Sektori L/J- veprimtari në lidhje me patundshmëri ,
- Shërbime nga departamenti 70- Shërbime konsultative .

3. Mbështetja financiare përfshin sigurimin e:

- mbështetjes me ekspertë në formë të stërvitjes për afarizëm dhe udhëheqje të biznesit, sistemit vauçer për përpunimin e planit të biznesit gjatë regjistrimit të tij në një shumë prej 17.940,00 denarësh.

- mbështetjen financiare dhe këshilldhënese për furnizimin me paisje ose repromateriale në një shumë prej 246.000,00 denarësh.

- mbështetjen financiare për punësimin plotësues të një personi, në formë të paisjeve ose materialeve në një shumë prej 92.000,00 denarësh për kandidatët të cilët do të paraqesin plan të qëndrueshëm të biznesit, e që tregon qartë se ka nevojë të punësojë edhe një person për funksionimin e suksesshëm të biznesit, por që edhe nëpërmjet parametrave ekonomik dhe financiar e dëshmon qëndrueshmërinë e punësimit plotësues. Personi që do të punësohet nëpërmjet grantit plotësues , duhet të jetë person i papunë e që në mënyrë aktive kërkon punë .

4. Personat që do t'i shfrytëzojnë mjetet financiare nga Programi për Vetëpunësim , nuk do të kenë të drejtë të kthehen në evidencën e të papunëve deri në skadimin e afatit të marrëveshjes ose deri sa nuk e kthen borxhin që është krijuar nga mosrespektimi i dispozitave të Marrëveshjes së nënshkruar, ose deri sa të kthejnë mjetet financiare me marrëveshje.

5. Nëse subjekti i themeluar me grant për vetëpunësim e ndërpret aktivitetin e tij, themeluesi/shfrytëzuesi i grantit obligohet të kthejë:

- 100% të vlerës së grantit, nëse edhe pas 3 muajve rradhazi nga momenti i regjistrimit të subjektit(firmës) si dhe 2 muajve nga vërrejtja e dërguar nuk realizon transaksione financiare nëpërmjet Drejtorisë së të hyrave publike;
- 80% të vlerës së grantit, nëse aktiviteti ndërpritet në afat prej një viti prej momentit të regjistrimit të firmës, ose
- 60% të vlerës së grantit, nëse aktiviteti ndërpritet në afat prej dy viteve prej momentit të regjistrimit të firmës .

6. Personat e papunë, të cilët janë të interesuar sipas pikës 1 të kësaj shpalljeje publike, fletëparaëqitjet e tyre mund t'i dorëzojnë më së voni deri më **10.03.2017** në klubet e punës së 30 qendrave të punësimit në RM.

7. Kushtet, të drejtat dhe obligimet më konkretisht do të përcaktohen me nënshkrimin e marrëveshjes së personave të papunë me APRM-në dhe UNDP-në.

Informata më të hollësishme mund të merren në klubet e punës së 30 qendrave të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë, në qendrën e kontaktit 02/3111-850 dhe ueb faqja www.avrm.gov.mk dhe www.rabotaimoznosti.mk

AGJENCIA E PUNËSIMIT
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË